| | |
|---|---|
| **Datë/a:** | 19.10.2021 |
| **Referenc-ë:** | 07-353/04-219856/21 |
| **Për/ Za/ To:** | "Baruti GmbH" –Dega në Kosovë |
| **Përmes/Preko/Through:** | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| **Nga/ Od/ From:** | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike<br><br>për Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| **Tema/ Subjekat/Subject:** | **Pëlqim** |

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-219856/21 nga "Baruti GmbH" –Dega në Kosovë me përfaqësuese Jetmira Zukaj të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Zahir Pajaziti" me datën 20 dhe 21 Tetor 2021 nga ora 09:00 deri në 17:00.
Qëllimi i kërkesës është ti njoftojnë qytetarët me kompaninë në fjalë dhe mundësin për aplikim pune.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, jep pëlqimin "Baruti GmbH" –Dega në Kosovë për shfrytëzimin e hapësirës publike me datë 20 dhe 21 Tetor 2021 në sheshin "Zahir Pajaziti" nga ora 09:00 deri në 17:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

**Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.**


Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi. P.N.-10.000 Prishtinë-Kosovë
http://www.prishtina-komuna.org